



Datë: 06. 05.2025
Numër protokoli: 3049/2025

A.nr.532/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.532/2025, të datës 24.03.2025, të parashtruar nga ankuesi R.H., kundër organit të punësimit: Agjencisë Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.532/2025, e datës 24.03.2025, e parashtruar nga ankuesi R.H., ashtu që, **detyrohet** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Pyjore të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesat e parashtruar nga ankuesi përmes parashtrësës me numër protokoli 249, të datës 29.01.2025 dhe parashtrësës me numër protokoli 267, të datës 31.01.2025 dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesat e shqyrtuara.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil R.H. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 23.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Pyjore të Kosovës, lidhur me kërkesat-ankesat e parashtruar nga ankuesi më datë 29.01.2025 dhe 31.01.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 04.04.2025, ka përcjell provat materiale lidhur me çështjen në procedurë duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1920/2025, të datës 24.03.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 249 të datës 29.01.2025; Kërkesën me numër protokolli 267 të datës 31.01.2025; Ankesën me numër protokolli 3582 të datës 02.09.2024; Deklaratën me numër protokolli 4198 të datës 14.10.2024; Deklaratën me numër protokolli 7010 të datës 29.11.2023; Ankesën me numër protokolli 4626 të datës 25.11.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 23.03.2025 të ankuesit për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën e datës 24.03.2025 të ankuesit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për mbajtje të seancës dëgjimore; Ankesën me numër protokolli 334 të datës 07.02.2025; Ankesën me numër protokolli 453 të datës 18.02.2025; Ankesën e numër protokolli 223 të datës 27.01.2025; Deklaratën me numër protokolli 673 të datës 06.03.2025; Kërkesën me numër protokolli 1068 të datës 06.03.2024; Ankesën me numër protokolli 7011 të datës 29.11.2023; Ankesën me numër protokolli 7502 të datës 05.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 2516 të datës 16.06.2023; Ankesën me numër protokolli 4298 e datës 05.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Akt Emërimit e datës 31.01.2012; Kërkesën me numër protokolli 01 e datës 03.01.2024; Kërkesën me numër protokolli 8065 të datës 18.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 7503 të datës 05.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 7502 të datës 05.12.2023; Tabelën e stafit të APK lidhur me përvojën e punës dhe moshën e datës 31.12.2023; Kërkesën e me numër protokolli 3740 e datës 25.09.2023; Kërkesën me numër protokolli 3903 të datës 09.09.2023; Kërkesën me numër protokolli 5191 të datës 21.11.2022; Ankesën me numër protokolli 3393 të datës 30.08.2022; Kërkesën me numër protokolli 3521 të datës 11.09.2023.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit ZP-83/2012 të datës 31.01.2012, mban pozitën e punës Zyrtar për Çështje Ekonomike, në Drejtorinë Koordinuese Gjilan, pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi fillimisht më datë 29.11.2023, ka parashtruar shkresë më emërtimin deklaratë tek zv. Drejtori Ekzekutiv i APKS-së, me të cilin ka deklaruar se nga kthimi në vendin e punës më datë 04.02.2022, është përballuar me linqime, sabotime, dhe mos dhënie të detyrave që i përkasin, ndërsa, më datë 11.10.2024, serish parashtron shkresë me emërtim deklaratë po tek u.d. Drejtori Ekzekutiv i APK-së, lidhur me përballjen e tij me pengesa e vështirësi pse sinjalizon dhe vazhdon të ankimoj për transferimin e përhershëm të zyrtarit B.Rr.

Meqë pretendon se nuk ka marr përgjigje në kërkesat apo deklaratat e tij, ankuesi më datë 29.01.2025, ka parashtruar shkresë me numër protokolli 249, me emërtim ankesë, përmes të cilës ka kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv i APK-së përgjigje ndaj ankimit për përfundimin e procedurës administrative, lidhur me ankesën mbi përballje me linqim duke tentuar të më linqojnë para stafit dhe palëve, si dhe më datë 31.01.2025 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 267 lidhur me transferimin e përhershëm të nëpunësit B.Rr, me qëllim të shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit dhe shqiptimit i transferimit si masë e pamjaftueshme profesionale. Mirëpo, që sipas provave të lëndës nuk ka marr përgjigje.

Ankuesi kundër heshtjes administrative të Drejtorit Ekzekutiv të APK-së, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që të detyrohet Drejtori Ekzekutiv i APK-së që të shqyrtoj kërkesat e tij.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 29.01.2029 dhe 30.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesat e ankuesit dhe të nxjerrë akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo brenda afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja dhe mos përgjigja e organit të administratës në raport me kërkesat e parashtruara përmes shkresës më numër protokolli 249, të datës 29.01.2025 dhe shkresës me numër protokolli 267, të datës 31.01.2025, cenojnë të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjen në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon në realizimin e disa të drejtave të cilat mendon se janë duke ju mohuar, apo shkelur.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit vetëm në kuptim të shkeljeve procedurale, duke detyruar Drejtorin Ekzekutiv të APK-së, që të shqyrtoj kërkesën me numër protokolli 249, të datës 29.01.2025 dhe kërkesën me numër protokolli 267, të datës 31.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesat e shqyrtuara.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.532/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit R.H.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe
Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.